

## **Detyrat e kryetarit të Komitetit**

*Kryetari i Komitetit drejton veprimtarinë e këshillit drejtues dhe të sekretariatit ekzekutiv dhe ka këto detyra:*

- a) thërret këshillin drejtues në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme dhe përcakton rendin e ditës;*
- b) drejton mbledhjet e këshillit drejtues;*
- c) nënshkruan vendimet e marra në emër të këshillit drejtues dhe të institucionit që përfaqëson;*
- ç) vërteton përputhjen e birësimit ndërvendas me dispozitat e konventës;*
- d) nënshkruan marrëveshje me institucione analoge jashtë vendit, me agjenci vendase dhe të huaja, që ndërmjetësojnë në fushën e birësimit;*
- dh) raporton për veprimtarinë e sekretariatit ekzekutiv përpara këshillit drejtues dhe për veprimtarinë e Komitetit përpara Ministrit të Drejtësisë;*
- e) përfaqëson Komitetin në marrëdhënie me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit;*
- ë) emëron ose largon nga detyra personelin e sekretariatit ekzekutiv, në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil dhe Kodin e Punës.*